



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°3/2021

Hagë, 30/09/2021

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku do t'ju ofrojmë informacion përmbledhës të përditësuar mbi proceset gjyqësore dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Të enjten e javës së shkuar, filloi me dhënien e dëshmisë dëshmitari i dytë i Prokurorisë në gjykimin e Salih Mustafës. Dëshmitari dëshmoi nën masa mbrojtëse, ku ndër të tjera përfshihet ndryshimi i pamjes dhe i zërit si dhe përdorimi i një pseudonimi.

Dëshmia e tij vazhdoi nga e hëna në të premten, ku dëshmitarit iu bënë pyetje nga prokurori, gjykatësit dhe avokatja që përfaqëson nëntë viktimat pjesëmarrëse si dhe ekipi mbrojtës i të akuzuarit.

Është planifikuar që gjykimi të vazhdojë ditën e hënën, 4 tetor, me dhënien e dëshmisë së dëshmitarit të tretë. Seanca është planifikuar nga ora 9:30 – 16:00.

Të enjten e javës së shkuar, Trupi Gjykses nxori vendim për zgjatjen e paraburgimit të z. Mustafa bazuar në arsyetimin se asnjë kusht nuk pakësonte mjaftueshëm rrezikun e pengimit të zhvillimit të procesit gjyqësor.

Vendimi si dhe parashtrimi i Mbrojtjes dhe parashtrimi i Prokurorisë lidhur me këtë pikë mund të gjenden në faqen zyrtare të DHSK-së.

Sipas Ligjit, gjykatësit duhet të rishikojnë çdo dy muaj vendimin nëse ekzistojnë ende arsytet për paraburgimin e të akuzuarit dhe të nxjerrin vendimin përkatës. Në këto arsye përfshihet rreziku i arratisjes, rreziku i pengimit të procesit gjyqësor apo rreziku i kryerjes së krimeve të tjera.

Është planifikuar që gjykimi në çështjen *Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt*, të fillojë të enjten më 7 tetor.

1





**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°3/2021

Hagë, 30/09/2021

Kryegjykatësi do të hapë gjykimin dhe do t'i kërkojë Zyrës së Prokurorit të Specializuar të lexojë Aktakuzën. Të akuzuarit do të pyeten nëse i kanë kuptuar akuzat e ngritura kundër tyre. Gjithashtu, Kryegjykatësi do t'i informojë rreth disa prej të drejtave dhe detyrimeve të tyre gjatë gjykimin. Gjykimi do të vazhdojë me deklaratën hyrëse të Prokurorisë.

Pritet që më 18 tetor të fillojë me dhënien e dëshmisë dëshmitarja e parë ndër tre dëshmitarët e Prokurorisë në çështjen *Gucati dhe Haradinaj*.

Prokuroria synon të përfundojë me paraqitjen e provave më 9 nëntor.

Faleminderit.

